

Plani Juaj Familjar Për Fatkeqësi

A e dini se ku do të
jetë familja juaj kur
godet fatkeqësia?

Ata mund të jenë kudo –



në punë



në shkollë




apo në automjet

si do gjeni njëri tjetrin?

A do ta dini nëse fëmijët
tuaj janë të sigurt

Fatkeqësitë mund të godasin shpejtë dhe pa paralajmërim. Ato mund të ju detyrojnë që të evakuoheni nga lagja juaj ose të ju ngujojnë brenda në shtëpi. Çfarë do të bëni nëse ju ndërpriten shërbimet elementare – uji, energjia elektrike apo telefonat? Zyrat lokal dhe punëtorët ndihmës do të jenë në vendin e ngjarjes pas fatkeqësisë, por ata nuk mund ta arrijnë menjëherë gjithsecilin prej jush.

Familjet mund të përballen me fatkeqësinë duke u përgatitur paraprakisht dhe duke punuar së bashku. Ndiqni hapat e renditura në këtë broshurë për ta hartuar planin tuaj familjar për fatkeqësi. Të diturit çfarë të bëni është mbrojtja juaj më e mirë dhe përgjegjësia juaj.



REZERVAT EMERGJENTE

Mbani rezerva të mjaftueshme në shtëpi për t'i plotësuar nevojat tuaja së paku për tri ditë. Përgatitni një Pako Emergjente me gjërat për të cilat mund të keni nevojë në një evakuim. Vendosni këto rezerva në kontejner të lehtë për tu bartur, siç janë çantat e shpinës apo edhe kontejnerët e mbeturinave të mbuluar me kapakë.



Përfshini:

- Rezerva uji për tri ditë (tri litra ujë në ditë për person) dhe ushqim që nuk rrjedh.
- Një palë rroba dhe çorape për person dhe një batanije apo thes fjetjeje për person.
- Një kuti të ndihmës së parë e cila përfshinë medikamentet e përshkruara për familjen tuaj.
- Mjete emergjente që përfshijnë radio me bateri, bateri ndriçuese dhe mjaftë bateri rezervë.
- Një komplet rezervë të çelësave të makinës dhe kartave të bankës, para të gatshme.
- Furnizime higjienike
- Gjëra speciale për foshnje, të moshuar apo me anëtar me aftësi të kufizuara.
- Një palë syze rezervë.

Mbani dokumentet e rëndësishme familjare në kontejner rezistues ndaj ujit. Mbani një pako më të vogël në bagazhin e makinës.

Shërbimet

Mësoni për ndërprerësit kryesor të energjisë elektrike dhe ujit. Mësoni si dhe kur ti ndërpritni këto shërbime. Mësoni të gjithë anëtarët përgjegjës të familjes. Mbani veglat e nevojshme afër ndërprerësit të ujit.

Mbani në mend: ndërpritni shërbimet vetëm nëse dyshoni që është prish rrjeti apo nëse udhëzoni të bëni ashtu.

4 Hapa drejt sigurisë

1

Gjeni se Çfarë Mund tu Ndodh

Kontaktoni zyrën lokale të menaxhimit emergjent dhe degën e Kryqit të Kuq të Kosovës – qëndroni të gatshëm për të mbajtur shënime:

- Pyetni se cilat fatkeqësi kanë gjasa më të mëdha të ndodhin. Kërkoni informacione lidhur me atë se si të përgatiteni për secilën prej tyre.
- Mësoni për shenjat e paralajmërimit të komunitetit tuaj: si tingëllojnë ato dhe çfarë duhet të bëni kur i dëgjoni ato.
- Pyetni për kujdesin ndaj kafshëve pas fatkeqësisë. Kafshët mund të mos lejohen në vendin e strehimit për shkak të rregullave shëndetësore.
- Kuptoni si ti ndihmoni të moshuarit apo personat me aftësi të kufizuara, nëse është e nevojshme.
- Tjetër, kuptoni lidhur me planet për fatkeqësi në vendin tuaj të punës, në shkollën apo çerdhen e fëmijëve tuaj, apo vendin ku e kalon ditën familja juaj

2

Hartoni Planin për Fatkeqësi

Takohuni me familjen tuaj dhe diskutoni lidhur me arsyen pse duhet të përgatiteni për fatkeqësi. Shpjegojuni fëmijëve rrezikun e zjarreve, motit të ashpër dhe tërmetin. Planifikoni ti ndani përgjegjësitë dhe punoni si ekip.

- Diskutoni fatkeqësitë që ka gjasa të ndodhin. Shpjegoni se çfarë duhet bërë në secilën rast.
- Zgjidhni dy vende për takim:
 1. Menjëherë jashtë shtëpisë tuaj në rast të emergjencës së papritur, siç është zjarri.
 2. Jashtë lagjes tuaj, në rast se nuk mund të ktheheni në shtëpi. Të gjithë duhet t'a kenë adresën dhe numrin e telefonit.
- Kërkoni nga një mik i juaji jashtë vendbanimit tuaj që të bëhet "pikë kontakti". Pas fatkeqësive më lehtë është të thirrren distancat e largëta. Anëtarët tjerë të familjes duhet ta thërrasin këtë person dhe t'i thon se ku gjenden. Të gjithë duhet ta dinë numrin tuaj kontaktues.
- Diskutoni se çfarë duhet bërë në një evakuim. Planifikoni si të kujdeseni për kafshët tuaja.

Plotësoni kopjen dhe shpërndaja të gjithë anëtarëve të familjes

PLANI FAMILJAR PËR FATKEQËSI

Vendi Takimit emergjent _____ jashtë shtëpisë _____

Vendi Takimit _____ Tel _____
jashtë lagjes tuaj

Adresa _____

Kontakti familjar _____ (emri)

Tel (_____) _____ ditën _____ Tel (_____) _____
nëntën

3

Plotësoni Këtë Listë

- | | |
|--|---|
| <input type="checkbox"/> Vendosni numrat e telefonave emergjent (zjarrfikjes, Policisë, autoambulancave, etj). | <input type="checkbox"/> Instaloni detektorët e tymit në çdo kat të shtëpisë, e sidomos në dhomat e gjumit. |
| <input type="checkbox"/> Mësoni fëmijë si dhe kur ta thërrasin 112-shin apo Shërbimin Mjekësor Emergjent | <input type="checkbox"/> Zhvilloni kontrollin e shtëpisë për rreziqe të mundshme. |
| <input type="checkbox"/> Tregoju anëtarëve të familjes si ta ndërpresin ujin dhe energjinë elektrike në ndërprerësit kryesor. | <input type="checkbox"/> Kontrolloni rezervat emergjente dhe përgatiteni Pakon Emergjente. |
| <input type="checkbox"/> Mësoi anëtarët e familjes si ta përdorin aparatën për fikjen e zjarrit (të llojit A, B, C) dhe tregoju ku është i vendosur. | <input type="checkbox"/> Merrni ndihmën e parë të Kryqit të Kuq. |
| | <input type="checkbox"/> Përcaktoni rrugët më të mira të ikjes nga shtëpia, gjeni nga dy dalje nga çdo dhomë. |
| | <input type="checkbox"/> Gjeni këndet e sigurta në shtëpi për çdo lloj fatkeqësie. |

4

Ushtroni dhe Mirëmbani Planin Tuaj

- | | | |
|--|--|----------------------------------|
| <input type="checkbox"/> Testoni fëmijët tuaj çdo gjashtë muaj që ta dine se çfarë të bëjnë. | <input type="checkbox"/> Testoni detektorët e tymit një here në muaj dh ndërroni bateritë së paku një here në vit. | |
| <input type="checkbox"/> Zhvilloni stërvitje zjarri dhe evakuimi | | |
| Viti: _____ data e Stërvitjes: _____ | <input type="checkbox"/> Janar | <input type="checkbox"/> Korrik |
| _____ | <input type="checkbox"/> Shkurt | <input type="checkbox"/> Gusht |
| _____ | <input type="checkbox"/> Mars | <input type="checkbox"/> Shtator |
| <input type="checkbox"/> Ndërroni ujin e deponuar çdo tre muaj dhe ushqimin çdo gjashtë muaj. | <input type="checkbox"/> Prill | <input type="checkbox"/> Tetor |
| <input type="checkbox"/> Kontrolloni aparatet për fikjen e zjarrit sipas rekomandimeve të prodhuesit | <input type="checkbox"/> Maj | <input type="checkbox"/> Nëntor |
| | <input type="checkbox"/> Qershor | <input type="checkbox"/> Dhjetor |
| | Ndërroi bateritë në _____ çdo vit (muaji) | |

FQINJËT NDIHMOJNË FQINJËT

Të punuarit me fqinjë mund të shpëtoj jetë dhe pasuri. Takohuni me fqinjët tuaj për të planifikuar se si lagja juaj mund të punoj së bashku pas fatkeqësisë derisa të arrij ndihma. Nëse jeni anëtar i ndonjë organizimi të lagjes, siç janë këshillat e bashkësisë për siguri, paraqiteni gatishmërinë për fatkeqësi si aktivitet të ri. Njilhu me shkathtësitë e veçanta të fqinjëve tuaj (si p.sh. teknike, mjekësore, etj) dhe merrni në konsideratë çështjen se si do mund t'i ndihmonit fqinjët që kanë nevoja të veçanta, siç janë të moshuarit dhe ata me aftësi të kufizuar. Bëni plane për kujdesin e fëmijëve në rastet kur prindërit nuk mund të arrijnë në shtëpi.

KONTROLLI I RREZIQEVE NË SHTËPI

Gjatë fatkeqësisë, objektet e zakonshme në shtëpinë tuaj mund të shkaktojnë lëndime apo dëme. Çdo gjë që mund të lëviz, thyhet apo shkaktoj zjarr është rrezik shtëpiak. Për shembull, nxehtësia e ujit të ngrohtë apo ormani i librave mund të bien. Inspektoni shtëpinë së paku një here në vit për rreziqet e mundshme.

Kontakttoni shërbimin tuaj lokal të zjarrfikjes për të mësuar për rreziqet e zjarrit në shtëpi



EVAKUIMI

Evakuohuni menjëherë nëse ju thuhet të veproni ashtu:

- Dëgjoni radion tuja me bateri dhe ndiqni udhëzimet e zyrtarëve lokal emergjent
- Vishni rroba mbrojtëse dhe këpucë të forta.
- Merrni me vete pakon Emergjente
- Shikoni shtëpinë.
- Përdorni rrugët e përcaktuara nga autoritetet lokale – mos i përdorni rrugët e shkurta sepse zonat e caktuara munden me qenë të pa kalueshme dhe të rrezikshme.

Nëse jeni i sigurt që keni kohë:

- Ndërpritni ujin dhe energjinë elektrike para ikjes, nëse udhëzoheni për një gjë të tillë.
- Lëni shënim për kohën e ikjes dhe vendin ku po shkonit.
- Merrni masat për kafshët tuaja shtëpiake.

NËSE GODET FATKEQËSIA

Nëse godet Fatkeqësia

Qëndroni të qetë dhe keni durim.
Futeni planin në veprim.

Kontrolloni për Lëndime

Jepni ndihmën e parë dhe kërkoni
ndihmë për personat e lënduar
seriozisht.

Dëgjoni radion tuaj me bateri për lajme dhe udhëzime

Evakuohuni, nëse udhëzoheni të
veproni ashtu. Vishni rroba
mbrojtëse dhe këpuçe të forta.

Kontrolloni dëmet në shtëpi...

- Përdorni bateri ndriçuese – mos
e ndërpritni energjinë elektrike
nëse dyshoni.
- Kontrolloni për zjarre, rreziqet
nga zjarrit dhe rreziqet tjera
shtëpiake.
- Ndërpritni çdo shërbim të
dëmtuar në shtëpi.
- Pastroni medikamentet e
derdhura, detergjentet,
karburantet dhe lëngjet tjera të
ndezshme menjëherë.



Mos harroni...

- Ti siguroni kafshët tuaja.
- Thërrisni kontaktin tuaj
familjar – mos e përdorni prapë
telefonin përveç nëse është
emergjencë kërcënuese për
jetën
- Kujdesuni për fqinjët tuaj, e
sidomos personat e moshuar
dhe ata me aftësi të kufizuara.
- Sigurohuni që të keni një
furnizim adekuat me ujë nëse
shërbimi me te ndërpritet.
- Qëndroni larg telave të
energjisë elektrike të varur
poshtë.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe Kryqi i Kuq i Kosovës janë institucione të cilat i ndihmojnë komunitetet anë e këndë vendit që të përgatiten për fatkeqësitë e të gjitha llojeve. Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni degën tuaj lokale të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Kjo broshurë dhe materialet tjera të gatishmërisë janë në dispozicionin tuaj në të gjitha zyret e degëve të Kryqit të Kuq të Kosovës

Sponsorizuar nga:

SHTRËNGATË PËRMBYTYJE ZJARR
RIEDHJE E MATERIEVE TE REZIKSHME

Plani Juaj

Familjar Për Fatkeqësi



Empowered lives
Resilient nations.

